

Statistikat e transportit

Janar 2020

Tiranë, më 27 Shkurt 2020: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Janar 2020 është 329 mijë ton, duke u rritur 10,3 %, krahasuar me Janar 2019.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë në muajin Janar 2020 është 3,1 milionë ton-kilometër, duke u rritur me 30,0 %, krahasuar me Janar 2019.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Det ton	Hekurudhë 000/tkm	Ajër* ton
Janar 2019	298.660	2.378	198
Janar 2020	329.373	3.091	177
Ndryshimi vjetor (%)	10,3	30,0	-10,6

* Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në muajin Janar 2020, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 177 ton mallra, duke u ulur me 10,6 %, në krahasim me Janar 2019.

Numri i fluturimeve të kryera, në Janar 2020 është 2.070 duke shënuar një rritje me 4,7 %, ndaj Janar 2019.

Tab. 2 Treguesit e transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Janar 2019	16	1.977	9.308
Janar 2020	17	2.070	11.019
Ndryshimi vjetor (%)	6,3	4,7	18,4

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare në Janar 2020 është 69.923 pasagjerë. Krahasuar me Janar 2019, ky tregues është rritur 5,0 %.

Në muajin Janar 2020, transporti ajror i pasagjerëve zë 77,8 % të transportit gjithsej.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Hekurudhë	Det	Ajër
Janar 2019	2.996	66.571	222.113
Janar 2020	0	69.923	245.680
Ndryshimi vjetor (%)	-100,0	5,0	10,6

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Janar 2020, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 64,8 mld lekë dhe 56,7 % e tyre u transportua me det.

Tab. 4 Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit


Mënyra e transportit	Eksport (mln lekë)		Import (mln lekë)	
	Janar 2019	Janar 2020	Janar 2019	Janar 2020
Transport detar	14.399	14.401	21.162	22.317
Transport hekurudhor	1	-	224	170
Transport rrugor	7.071	7.920	16.406	17.426
Transport ajror	68	84	1.513	1.230
Të tjera	311	574	2.784	633

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Eksportet e mallrave

Në Janar 2020, mallrat e eksportuara me det zënë 62,7 %, me rrugë 34,5 % dhe me ajër 0,4 %. Mallrat e eksportuara me rrugë janë rritur me 12,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Janar 2020 (%)




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritje të INSTAT

Importet e mallrave

Në Janar 2020, mallrat e importuara me det zënë 53,4 %, me rrugë 41,7 % dhe me ajër 2,9 %.

Mallrat e importuara me rrugë, në Janar 2020 janë rritur me 6,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Janar 2020 (%)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritjet të INSTAT

Metodologji

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve, sipas llojeve, si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit, në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007) është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë